



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti - Republika Kosova – Republic of Kosovo

**MAMUŞA BELEDİYESİ - KOMUNA E MAMUSHËS
OPSTINA MAMUSA - MUNICIPALTY OF MAMUSA**

KUVENDI I KOMUNËS SË MAMUSHËS

RREGULLORE PËR PËRDORIMIT TË AUTOMJETEVE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS

MAMUSHË / Korrik 2010

Në zbatim të dispozitave të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, ligji Nr. 03/L-040 dhe të Statutit të Komunës Mamushës të dt. 01.12.2008, Kuvendi i Komunës së Mamushës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.07.2010 miraton këtë:

R R E G U L L O R E

Për kushtet dhe mënyrat e përdorimit të automjeteve të Komunës të Mamushës

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me qëllim të përdorimit sa më racional të automjeteve zyrtare, pronë e Komunës së Mamushës, me dispozitat e kësaj rregulloreje caktohen kushtet e shfrytëzimit të veturave nga ana e stafit civil (në tekstin e më tutshëm zyrtarët e autorizuar) për nevojat zyrtare.

Neni 2

Punë zyrtare konsiderohen të gjitha punët që kryhen në llogari të Komunës së Mamushës, jashtë objektit të selisë së Komunës së Mamushës për të cilat duhet të shfrytëzohen përdorimi i veturave zyrtare.

Neni 3

Kryetari i Komunës në raste të veçanta mund të bjerë vendime që kanë të bëjë me kushtet e përdorimit të automjeteve për shërbyesit civilë. Këto raste duhet taksativisht të precizohen.

Në këto raste vendime konform par. 1, të këtij neni është aneks i kësaj rregulloreje.

Neni 4

Shpeditimin, evidentimin e përdorimit dhe shpenzimet e mirëmbajtjes e mban Drejtoria e Administratës së Përgjithshme. Ai raport vjetor i jep Kryetarit të Komunës. Raportet mund të jenë edhe periodike, varësisht nga kërkesa e Kryetarit të Komunës.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 5

Kryetari i Komunës dhe Nënkryetarët e Komunës kanë të drejtë në shfrytëzim të automjeteve sipas vlerësimit personal në çdo kohë.

Me kërkesën e kryetarit të Komunës, nënkryetarëve të Komunës brenda mundësive financiare mund t'iu caktohet vozitës i tyre personal.

Neni 6

Kërkesën për përdorimin e automjeteve e bëjnë Drejtori përkatës ose personi i autorizuar nga ai si dhe kërkesa bëhet një ditë para përdorimit të automjetit.

Në raste të veçanta kërkesa mund të bëhet edhe gjatë ditës së shfrytëzimit, por me lejen e Drejtori përkatës.

Në kërkesë duhet të cekët: Caku dhe arsyeja e shfrytëzimit, kurse konform par. 2 të këtij neni edhe shkaqet e urgjencës.

Kërkesa për shfrytëzimin e automjetit i drejtohet Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme.

Neni 7

Për shfrytëzimin e automjetit jashtë territorit të R. së Kosovës, personi përgjegjës i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është i obliguar që të njoftojë Drejtorin e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme .

Për këto raste është e nevojshme edhe leja e Kryetarit të Komunës ose personit që e zëvendëson .

Neni 8

Në rast të tejkalimit të kërkesave për përdorim të automjeteve për ditën e njëjtë, koordinimin dhe prioritetin e bën “Drejtorja e Administratës së Përgjithshme”, duke pasur parasysh urgjencën/rëndësinë për punën që duhet të kryhet.

Neni 9

Shfrytëzimi i automjetit është i ndaluar në distancë më të vogël se 2.5 km. Në raste të veçanta përjashtohet par.1 i këtij neni, por lejen e jep Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme.

Neni 10

Shfrytëzuesi i automjetit është i obliguar të nënshkruaj relacionin dhe km. e bëra për punën zyrtare.

Neni 11

Personi i ngarkuar me automjetin është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastërtinë e tij. Në raste të avarisë dhe defekteve, personi i ngarkuar me automjetin është i obliguar që ta njoftojë përgjegjësin për veprimet e më vonshme.

Për shkeljet e rregullave të komunikacionit, përgjegjësia i bie personit të ngarkuar me automjetin .

Për sigurinë e personave zyrtarë dhe të veturave është i ngarkuar personi i ngarkuar me automjetin .

Neni 12

Personi i ngarkuar me automjetin është i obliguar që të ruaj automjetin zyrtarë, në rast të nevojshëm të pres personat zyrtar deri sa të kryen punët zyrtare jashtë/brenda selisë së Komunës së Mamushës.

Neni 13

Të gjitha informatat zyrtare që personi i ngarkuar me automjetin i mëson/dëgjon nga personat zyrtar konsiderohen sekret i punës.

Përhapja e këtyre të dhënave, publikisht konsiderohet shkelje e detyrave të punës.

Neni 14

Është e ndaluar për personin e ngarkuar me automjetin që personave jokompetent t’u bëhet e ditur relacioni i rrugës së personave zyrtar.

Par. 1 i këtij neni vlen me rastin e ardhje – vajtjes pas kryerjes së punës zyrtare. Mosrespektimi i par. 1 i këtij neni , paraqet cenim të detyrave të punës.

Neni 15

Personi zyrtar që e shfrytëzon automjetin nuk ka të drejtë të fajësojë personin e ngarkuar me automjetin për shkeljen e rregullave të komunikacionit, pa marr parasysh arsyen.

Neni 16

Automjetet pas përfundimit të orarit të punës / udhëtimit zyrtar, parkohen në parkingun përkatës të Komunës.

Përfundim nga par. 1 i këtij neni, ka të bëjë për: Automjetin e kryetarit të komunës.

Ky përfundim në raste të intervenimeve dhe urgjencave për punët zyrtare vlen edhe për inspektorët e Komunës së Mamushës.

Për raste të par. 3 i këtij neni, lejen e jep Drejtori i Drejtorisë përkatës për rastet e ndërmarra.

Neni 17

Furnizimin me karburante, personi i ngarkuar me automjetin është i obliguar ta bëjë përmes zyrtarit për furnizim i caktuar nga ana e Drejtorit të Administratës së Përgjithshme, i cili e mban evidencën e shpenzimeve dhe km. e kaluara.

Përqindja e shpenzimeve përcaktohet në bazë të sasisë së shpenzuar dhe km. të kaluara dhe kjo procedurë e vlerësimit është e obligueshme.

Përqindja e lejuar e shpenzimeve / koeficienti , përcaktohet nga ana e komisionit nëse shpenzimet në tre muajt e përdorimit e kalojnë normën teknike të përcaktuar nga prodhuesi i automjetit.

Neni 18

Në dokumentacionin e ngarkim shkarkimit me karburante hynë: kartela e ngarkesës, libri i shkarkesës së urdhëresës së udhëtimit me të cilën përcaktohen km. e kaluara.

Neni 19

Për mos respektimin e dispozitave të kësaj rregulloreje nga ana e personit të ngarkuar me automjetin, pasojnë masa disiplinore për shkeljen e rregullave të punës konform rregullores për përgjegjësinë disiplinore.

Neni 20

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Në ditën e miratimit të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e Kuvendit të PNJK së Mamushës, që ka të bëjë me çështjet që rregullohen me këtë Rregullore.

Neni 21

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Mamushës.

KUVENDI I KOMUNËS MAMUSHA

Nr. 01/2010

Me dt. 30.07.2010

Kryesuesja e Kuvendit Komunal,
Seylan Mazrek
